



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: + 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 140/2023

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Agon Ramadani Kryetar, Vedat Poterqoi-Anetar, Kimete Gashi- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së OE "Imk Ballkan Projekt" SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbime Laboratorike për ekzaminimin e materialeve ndërtimore" me numër të prokurimit 616-22-14438-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, më 26/06/2023, mori këtë:

VENDIM

1. Aprovohet si e bazuar, ankesa e "Imk Ballkan Projekt" SH.P.K. me nr. 2023/0140, e datës 15/03/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbime Laboratorike për ekzaminimin e materialeve ndërtimore", me numër të prokurimit 616-22-14438-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, ndërsa lënda kthehet në rivlerësim.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj me shkrim OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, të precizuar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi, në të kundërtën OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
3. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse Ankuesi ka të dejtë që në afat prej 60 (ditëve) të parashtrroj kërkesë për kthimin e mjeteve, në të kundërtën të njëjtat konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 31, par 6 të Rregullores për Punën e Bordit të OSHP.

Arsyetim

Me datën 19.12.2022 Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbime Laboratorike për ekzaminimin e materialeve ndërtimore" me nr. të prokurimit: 616-22-14438-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës. Me datën 12.01.2023, AK ka publikuar formularin për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara.

OE "Imk Ballkan Projekt" SH.P.K. me datën 07.03.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. AK me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues "Imk Ballkan Projekt" SH.P.K., me datën 15.03.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/0140, lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkritazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 24/03/2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i rekomandon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të hedhet poshtë si e pa bazuar

Paneli Shqyrtues konsideroj se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtruesat e tyre, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

-Konstatimet dhe përfundimet e panelit shqyrtues

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit të jashtëm shqyrtues, konstaton se raporti i ekspertizës nuk ka gjetur mbështetje nga ana e panelit për faktin se në të nuk është evidentuar ndonjë e gjetur, analizë, hulumtim apo shqyrtim i pretendimeve ankimore, ndërsa në pjesën ku eksperti është dashur ti paraqesë këto të dhëna i njëjti ka paraqitur përgjigjet e AK-së ndaj kërkesës për rishqyrtim të OE ankues, e jo përgjigjet e tij, andaj në këtë rast PSH në bazë të autorizimeve dhe kompetencave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi ka trajtuar pretendimet ankimore në mënyrë të pavarur pa u bazuar në

raportin e ekspertit, kështu që si rrjedhojë është arritur deri tek vendim-marrja sikurse në dispozitiv të këtij vendimi duke u bazuar në shtjellimet e mëposhtme.

Pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e OE ankues konsistojnë në:

1. Pretendimi i parë (I) i Operatorit Ekonomik (OE) ankues:

Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 108/A, për faktin se pas publikimit të vendimit të AK-se (Formularit B-58), e ka anuluar, konkretisht e ka fshirë nga sistemi, pa pranuar asnjë ankese nga Operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të Prokurimit. Pretendimi i AK-së se behet fjalë për një gabim teknik nuk qëndron sepse aty e ka shënuar emrin e kompanisë tone.

Sipas Neni 63 paragrafit 1.2 të Rregullores 001/2022 për prokurim publik, Autoriteti Kontraktues duhet që Njoftimin mbi vendimin e AK-së ta anulojë vetëm pas pranimit të një ankese nga ndonjë operator ekonomik i cili ka marr pjesë në atë aktivitet të Prokurimit dhe gjithashtu duhet që të nxjerr vendim ku aprovohet kërkesa për rishqyrtim e atij operatori ekonomik.

2. Pretendimi i dytë (II) i Operatorit Ekonomik (OE) ankues.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, i cili nuk i plotëson kriteret sipas dosjes se tenderit. OE i rekomanduar për kontratë, në dosjen e ti të tenderit ka ndryshime të paramasa e çmimit të ofruar me çmimin e dhënë në njoftimin mbi vendimin e AK-së.

Lidhur me pretendimin e parë (I) ankimor të OE ankues, paneli shqyrtues vlerëson se AK kriter për dhënie të kontratës ka qenë operatori ekonomikisht i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, ndërkaq AK në raportin e vlerësimit ka konsideruar si të përgjegjshëm gjashtë ofertues, fillimisht duke rekomanduar për kontratë IMK Ballkan Projekt SHPK me çmim 10.43 ndërsa në njoftimin e njejtë OE më i lirë pjesëmarrës (IPE-Proing SHPK) ishte eliminuar me arsyetimin e mos plotësimit të kriterit lidhur me përfundimin e kontratave të njëjta apo të ngjashme (paraqitjen e dëshmimeve), OE i përgjegjshëm me çmimin më të lirë sipas njoftimit të AK-së ishte shpallur IPE-Proing SHPK me çmim 8.78. Të njëjtin njoftim AK me datën 02.03.2023 e ka ndryshuar me arsyetimin se ka ndodhur një gabim teknik meqë nuk është rekomanduar si tenderues i suksesshëm OE (i përgjegjshëm) me çmimin më të lirë por është rekomanduar OE ankues me çmimin e dytë më të lirë që në këtë rast është IMK Ballkan Projekt SHPK me çmim 10.43, në të njëjtën ditë pas pak orëve, sipas arsyetimit të AK-së komisioni vlerësues në konsultim edhe me KRPP ka korrigjuar gabimin teknik që ka ndodhur. Në këtë mënyrë me dt. 02.03.2023 është publikuar B58 Letër standarde tjetër për tenderuesin e suksesshëm për korrigjimin e njoftimit mbi vendim të AK së bashku me njoftimin për vendimin e korrigjuar të AK përmes të cilit si tenderues i suksesshëm është rekomanduar IPE-Proing SHPK, si OE i përgjegjshëm me çmimin më të lirë 8.78.

Paneli shqyrtues në rastin konkret ka konsideruar argumentimet e të dyja palëve, dhe në këtë rast është evidente që anulimi i vendimit dhe procedurat e shqyrtimit dhe trajtimit përcaktohen me legjislacionin në fuqi, por poashtu në rastin konkret PSH ka konsideruar arsyetimin e AK-së se ka ndodhur gabim teknik me rastin e lëshimit të vendimit, andaj duke qenë se lënda kthehet në rivlerësim për arsyet që do të shtjellohen në pretendimin nr.2 PSH konstaton se ky pretendim klasifikohet si pjesërisht i bazuar për faktin se në aspektin procedural kemi të bëjmë me shkelje të dispozitave ligjore, konkretisht nenit 63 paragrafit 1.2 të Rregullores 001/2022 e

poashtu nenit 108/a të LPP-së (zgjidhja preliminare e kontesteve), por në rastin konkret është marrë në konsideratë edhe arsytimi i AK-së se kjo ka qenë si shkak i gabimeve teknike që më pas janë korrigjuar me ndihmën e KRPP-së.

Lidhur me pretendimin e dytë (II) ankimor të OE ankues, PSH ka bërë përmbledhjen e pretendimeve ankimore rreth çmimeve, ku OE ankues ka pretenduar se në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, konkretisht në paramasën e tij është ofertuar me më shumë se dy numra pas presjes dhjetore si dhe në dosjen e ti të tenderit ka ndryshime të paramasa e çmimit të ofruar me çmimin e dhënë në njoftimin mbi vendimin e AK-së.

Lidhur me këto pretendim, PSH ka evidentuar se çmimi i dhënë në paramasën e OE të rekomanduar për kontratë është i paraqitur me më shumë se dy numra pas presjes dhjetore, konkretisht, 8,779 €.

Lidhur me këtë PSH konstaton se AK në DT ka lejuar ofertimin në këtë mënyrë, konkretisht pika 20.1 në DT saktëson:

“Të gjitha çmimet e specifikuar në tender duhet të deklarohen në Euro (€) dhe duhet të përfshinë të gjitha taksat e aplikueshme, detyrat dhe pagesat tjera. Çmimi i ofertuar lejohet që të shenohet me maksimum dy (2) numra pas preses dhjetore. Çdo numer i shenuar pas numrit të dyte (2) nuk do të merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertes.”

Andaj, duke qenë se numrat e shënuar pas numrit të dytë nuk do të merren parasysh në llogaritje të vlerës së ofertës, PSH konstaton se është evidente se kemi ndryshime çmimi në paramasën e OE të rekomanduar si dhe njoftimin e AK-së e poashtu në formularin e tenderit, në të cilat është i paraqitur çmimi prej 8,78 €, andaj obligohet AK që përgjatë procedurave të rivlerësimit të ndërmarrë veprimet procedurale konform dispozitave në fuqi, e poashtu në rast eventual rekomandimeve të KRPP-së në aspektin e interpretimeve të dispozitave ligjore.

Kështu që rrjedhimisht, paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës, ka arritur në përfundimin se si shkak i arsyeve të dhëna si më sipër lënda duhet të kthehet në rivlerësim për faktin se në rastin konkret PSH konstaton se AK nuk ka vepruar në harmoni 59 të LPP-së gjatë zhvillimit të kësaj procedurë të prokurimit, andaj obligohet AK që përgjatë procedurave të rivlerësimit, të veprojë me neni 60 dhe neni 59 të LLP-së, me saktësisht në harmoni me kriteret për dhënie të kontratës.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues

Agon Ramadani



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – “KK- Prishtinë”,

1x1 OE - IMK Ballkan Projekt SHPK.– Prishtinë,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.